

Demokracia dhe Sociologjia
Dr. Lekë Sokoli

(Me rastin e 21 nëntorit, ditës së themelimit të Institutit të parë Shqiptar të Sociologjisë)
(Botuar në "Tirana Observer", datë 23 nëntor 2006)

Ka shkencë që janë zhvilluar, sado në shkallë të ndryshme, pavarësisht nga sistemi shoqëror. Madje jo vetëm shkencë tekniko-natyrore, por edhe shoqërore. Megjithatë shkallën më të lartë të ndjeshmërisë së tyre, sidomos ndaj sistemit politik. Sigurisht demokracia krijon hapësira të vërteta për kërkimin e lirë shkencor. Por, ama, ka një shkencë e cila mund të zhvillohet e të lulëzojë plotësisht vetëm në një sistem demokratik. Kjo është sociologjia.

Ishte pikërisht Ogyst Konti, babai zyrtar i sociologjisë, ai që bëri një vlerësim të progresit të dijes njerëzore, nga shkencat më të thjeshta e më të përgjithshme, deri tek ato më komplekse e më të specializuara. Nisur nga kompleksiteti i tyre, ai ka dhënë këtë klasifikim të shkencave: Matematika, astronomia, fizika, kimia, biologjia (këtu nisin fenomenet e jetës) dhe, së fundi, sociologjia. Pra, fakti që sociologjia vjen e fundit në hierarkinë e shkencave, na tregon haptas kompleksitetin e tmerrshëm të faktorëve që hyjnë në vorbullën e jetës shoqërore. Por vepra e Kontit, këtij teoricieni të sociologjisë, përkon në kohë, siç duket jo aq rastësisht, me veprën "Demokracia në Amerikë", të Aleksis Tokëvilit, këtij teoricieni të demokracisë. Veprat e tyre janë botuar, pjesë-pjesë, në të njëjtën dekadë, në vitet 1830-1840.

Pra sociologjia është shkencë e demokracisë dhe institucioneve demokratike. Të paktën në asnjë sistem tjetër shoqëror, të dy shekujve të fundit (të pas lindjes së sociologjisë), ajo nuk ka njohur ndonjë zhvillim. Duket se rezulton njëfarë rregullsie, në raportin midis indeksit të demokracisë dhe indeksit të zhvillimit sociologjik. Sociologjia nuk u zhvillua sidomos nën regjimet totalitare. Revolucioni Rus, për shembull, i dha fund vrullit sociologjik. Njësoj revolucioni kulturor kinez, regjimi i gjeneralëve grekë (vetëm 3-4 dekada më parë) etj. Njësoj revolucioni komunist shqiptar.

Sociologjia, rasti i Shqipërisë

Nën regjimin komunist shqiptar, sociologjia mbeti një shkencë e ndaluar, jolegjitime, "e panevojshme", apo "borgjeze, e rrezikshme." Të flitej për sociologji, jashtë materializmit historik, ishte mëkat. E vetmja, me atributin e të vërtetës absolute, ishte "vija e Partisë". Tekstet, botimet, punimet shkencore, disertacionet etj., duhej të përshkoheshin si fill i kuq nga kjo vijë, e cila duhej të pranohej si një dogmë, si një besim, si një teori që "nuk verifikohet". Sociologjia, si disiplinë shkencore, mbeti e papërfshirë në programet mësimore të shkollave të larta e të mesme, nuk kishte një departament sociologjie në universitete, një institut sociologjie pranë Akademisë së Shkencave etj. Pra, sociologjia mbeti e painstitucionalizuar.

Nuk pati, gjithashtu, shkëmbime përsa i përket përgatitjes së specialistëve sociologë, shkëmbimit të literaturës sociologjike, pjesëmarrje në shoqata apo veprimtari shkencore ndërkombëtare etj. Shqipëria mbeti, edhe përsa i takon sociologjisë, vendi i tabuve, i të ndaluarave. Siç nuk u lejuan të gjitha shkollat e mendimit (veç marksizmit), siç u ndaluan veprat e Platonit, Aristotelit, Hegelit, Fojerbahut, Dostojevskit, Frojdit, Sartrit etj., nuk u lejuan edhe veprat e sociologëve të mëdhenj, si Konti, Tokëvili, Durkheim, Veber, Simel, Pareto, Poper, Mill, Parsons etj. Duke dhënë një shembull gati unikal në botë. Shqipëria, ndryshe nga vendet e tjera të Lindjes evropiane, nuk e ndryshoi qëndrimin ndaj sociologjisë edhe pas rënies së stalinizmit. Sociologjia mbeti ose "borgjeze", ose "revizioniste". Qëndrimi "as, as" (as Lindje, as Perëndim), si për politikën, ekonominë etj. mbeti pothuaj i pandryshuar edhe për sociologjinë.

Mohimi zyrtar i sociologjisë në Shqipëri nuk ishte rastësi. Së pari nuk kishte liri. Ndërtimi (zhvillimi, organizimi), ishte i bazuar jo në shkencat sociale, por në "urdhrin komunist". Kuadri në të cilin punonin e jetonin njerëzit ishte relativisht stëbël (pa lëvizje sociale). Çdo individ zinte një pozicion që më shumë "i jepej", kryente një punë rutinë, sillej sipas normave të pranuara, i bindej pa kushte autoritetit. "Brigadieri i fshatit i shikonte të gjithë bashkëfshatarët tek kryenin detyrat e dhëna prej tij" (nëse shprehemi figurshëm për të karakterizuar një realitet social të lexueshëm, tëurvejuar, rural, pak a shumë homogjen, pra një "status quo"). Kuptohet se për shkencën e sociologjisë nuk mund të kishte hapësira.

Ndryshe nga Lindja evropiane (!)

Në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Lindore, para vitit 1990, ishte krijuar një traditë në zhvillimin e sociologjisë. Në Rusi, për shembull, për zhvillimin e sociologjisë, edhe para revolucionit të 1917-ës, dëshmon fakti që Sorokini drejtoi, deri në vitin 1924, Institutin e parë të Sociologjisë, pranë Universitetit të Petrogradit. Në Hungari, gjithashtu, sociologjia ishte diferencuar si disiplinë e veçantë universitare, të paktën që nga viti 1919, kur Karl Mannheim u emërua si profesor i sociologjisë në Universitetin e Budapestit. Të tillë shembuj mund të gjenden edhe në vende të tjera të Lindjes evropiane, sidomos në Poloni, Hungari, Rumani etj.

Pra, në vendet e Lindjes evropiane u fol dhe u shkrua nën emrin sociologji. Ajo u institucionalizua, në shkallë të gjerë, sidomos në vitet 60-të, kur u krijuan institute të sociologjisë ose degë pranë akademive të shkencave, zyra të kërkimeve sociologjike, pa përmendur universitetet; u botuan buletine e botime periodike të veçanta, u krijuan profesione sociologësh: fabrike, urbanist, fshati, sociolog industrial etj.

U aplikua, gjithashtu, punësimi i sociologëve në degë të ndryshme të ekonomisë, sidomos në industri. Në Poloni, për shembull, sociologu i parë u punësua në vitin 1959 dhe, 12 vjet më vonë, vetëm në industrinë e këtij vendi ishin punësuar mbi 200 sociologë, që përbënin 40 për qind të sociologëve të diplomuar. Pa përmendur ata që ishin angazhuar pranë instituteve shkencore apo universiteteve. Njëherësh theksohet edhe një shkallë e pranueshme, që varionte deri në 60 për qind, e aplikimit në praktikë të rekomandimeve të studimeve sociologjike. Duhej pritur "destalinizmi", natyrisht, që sociologjia të rehabilitohej dhe të konsiderohej "një instrument i nevojshëm". Shoqata Sovjetike e Sociologjisë, për shembull, u krijua më 1958. Në vitet e mëvonshme sociologjia "lindore" njohu një periudhë liberalizimi të mëtejshëm, njëfarë "ndërgjegjësimit metodologjik" e hapjeje ndërkombëtare.

Pavarësisht zigzakeve e zhvillimit të pabarabartë midis vendeve, tabuve relative të imponuara nga pushteti etj., në Lindjen evropiane sociologjia u zhvillua, madje u institucionalizua.

"Rjedhave të sociologjisë..." e "Në kërkim të faktit sociologjik"

Në Shqipëri, pavarësisht disa studimeve me problematikë sociale, pa iu referuar drejtpërdrejt sociologjisë (sidomos të disa autorëve, si Hamit Beqja, Alfred Uçi etj.), debati nëse duhej të zhvillohej sociologjia si shkencë e veçantë, filloi vonë, në gjysmen e dytë të viteve '80-të. Pra kur në botë ndërkombëtarizimi i sociologjisë kishte përfunduar si proces: nuk kishte asnjë shoqëri të industrializuar që të mos udhëhiqej prej saj, siç nuk kishte asnjë shoqëri në zhvillim që të mos e njihje atë. Madje edhe atëherë ky debat u zhvillua midis një numri shumë të kufizuar studiuesish (kryesisht pjesëtarë të Rrethit Shkencor të Filozofisë të Universitetit të Tiranës), ndër të cilët Hamit Beqja, Servet Pëllumbi, Fatos Tarifa, Artan Fuga, Tefik Çausi, Kosta Barjaba, Fatmir Zani etj., kontributi i të cilëve meriton të

theksohet, në mënyrë të veçantë. Njëzet vjet më parë filloj, gjithashtu, të jepej një "Kurs special për sociologjinë". Pedagogët e saj të parë ishin Servet Pëllumbi e Fatos Tarifa.

I pari libër referuar sociologjisë, në Shqipëri është "Rrjedhave të sociologjisë së kulturës e të edukatës", shkruar nga prof. Hamit Beqja, i botuar më 1989. Në studimin "Rreth sociologjisë së edukatës, të kulturës, të informacionit", të shkruar në dhjetor 1988, autori ka bërë, besoj për të parën herë, përkufizimin e sociologjisë si shkencë, ka dhënë objektin e saj, sikurse vendin e saj midis shkencave sociale etj., etj. Në këtë libër është operuar me disa kategori sociologjike e grupe sociale, siç është folur për degët e nëndegët e saj.

Më 1990, sociologu Fatos Tarifa do të botonte, pas një vargu peripecish e pengesash absurde, librin "Në kërkim të faktit sociologjik", të parin libër për metodikat e studimeve shkencore sociologjike. Në dhjetor 1990, në rezonancë me lëvizjen demokratike, u themelua Shoqata Sociologjike Shqiptare e cila, për fat të keq, nuk e pati jetën e gjatë. Vrulli ynë sociologjik i asaj kohe pësoj një goditje të madhe në gusht 1992, kur u mbyll Fakulteti i Filozofisë dhe Sociologjisë, me vetëm një viti jetë (!).

Pra çështja e institucionalizimit të sociologjisë në Shqipëri mbeti sërish një çështje e shtruar për zgjidhje.

Instituti i parë shqiptar i Sociologjisë

Në këtë rrjedhë, vijmë te themelimi i të parit institut shqiptar të sociologjisë. Ai daton më 21 nëntor 2006. Themelimi i tij është në vijim të përpjekjeve të një numri individësh shqiptarë, që i janë përkushtuar në këto vite kërkimit shkencor sociologjik. Krijimtaria e tyre është pasqyruar në "Mendimi sociologjik shqiptar, 1986-2006, bibliografi", e cila përfaqëson edhe botimin e parë të Institutit të Sociologjisë, e promovuar pikërisht në ditën e themelimit të tij.

Krejt ndryshe nga përvoja e vendeve të tjera, së cilës jo rastësisht iu referuam më sipër, Instituti i Sociologjisë u krijohet në kushtet kur (1) Shqipëria kishte mbetur e fundit pa një institucion sociologjie. Madje jo vetëm kundrejt pjesës Perëndimore të botës, por edhe kundrejt pjesës tjetër të saj. Kongresi i 36-te botëror i sociologjisë, për shëmbull, është zhvilluar në Kinë, në vitin 2004. Instituti i Sociologjisë u krijua, më tej, në kushtet kur (2) në listën zyrtare të profesioneve në Shqipëri nuk ekziston profesioni i sociologut. Pra nuk ka një treg zyrtar pune për ta. Instituti i Sociologjisë u krijua kur (3) ende nuk ka një degë sociologjie në universitetet tona, publike apo private (Universiteti i Tiranës, fakulteti i Shkencave Sociale, diplomon në degan filozofi-sociologji, por jo me vete, sociologji). Instituti i Sociologjisë u krijua, së fundi, në kushtet kur (4) është bërë e qartë se një institucion i tillë nuk do të krijohet pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ajo vetë, krejt paradoksalisht, "ka dalë në ankënd".

Dyzetetre anëtarët themelues të Institutit të Sociologjisë janë: Hamit Beqja (akademik); Alfred Uçi (akademik); Servet Pëllumbi; Lekë Sokoli; Ilir Gëdeshi; Sejdin Cekani; Ismet Elezi; Zamira Sinoimeri; Olta Xhaçka; Tonin Çobani; Enis Sulstarova; Enkeleda Stefani; Sotiraq Hroni; Bonina Graceni; Erjona Këruti; Ervisa Jusufaj; Manuela Xhuti; Pranvera Goxhaj; Kledia Boni; Drini Demolli; Eva Dafa; Endri Lohja; Silvana Haxhiaj; Jashar Demiri; Gezim Tushi; Skëndër Demaliaj; Edison Zylalaj; Eglantina Gjermani; Milva Ekonomi; Vadiola Muça; Denis Behluli; Elda Dakli; Estela Mano; Blendi Çeka; Nora Malaj; Fatos Tarifa, Sabri Këçmari, Mirela Bogdani, Klejda Mulaj, Rando Devole, Enkeleda Tahiraj, Marina Dalla dhe Roland Sejko.

Që në themelimin e tij Instituti I Sociologjisë ka disa anëtarë nderi, sociologë të shquar të kohës sonë, si Judith Blau, Jay Weinstein, Barbara Heyns, Liqun Cao etj.

Bordi Akademik, i zgjedhur nga Asambleja e parë e Institutit të Sociologjisë përbëhet nga Alfred Uçi (akademik), Servet Pëllumbi, Nora Malaj, Enis Sulstarova, Tonin Çobani, Gëzim Tushi e Silvana Haxhijaj. Kryetar i Institutit të Sociologjisë është prof. dr. Servet Pëllumbi, ndërsa zëvendëskryetare znj. Nora Malaj. Asambleja e parë e Institutit të Sociologjisë zgjodhi dy drejtorë të tij: dr. Lekë Sokoli (drejtor ekzekutiv) dhe dr. Fatos Tarifa (drejtor për Marrëdhëniet Ndërkombëtare).

Ndërsa profesor Hamit Beqja, akademik, u zgjodh unanimitisht Kryetar Nderi i Institutit të Sociologjisë.

Rikthehemi në pikënisjen e këtij shkrimi, në raportin midis demokracisë e sociologjisë. Instituti i Sociologjisë është një institucion demokratik. Besoj për t'u marrë shembull. Të paktën përsa i takon procedurave të funksionimit të tij, zgjedhjes së organeve drejtuese, parimeve udhëheqëse të tij, siç janë: puna në grup, anëtarësia, gjithëpërfshirja, vendimmarrja kolegjiale, hierarkia e vlerave shkencore dhe e kontributeve të tjera të domosdoshme për zhvillimin e kërkimit shkencor sociologjik, transparenca e veprimtarisë dhe komunikimi i hapur (kryesisht në rrjet) midis anëtarëve, rigoroziteti shkencor akademik etj.

Instituti i Sociologjisë, siç është një organizëm shumëvlerësh e shumëkahësh, është edhe një institucion shumëbrezash. Madje si asnjë institucion tjetër i shoqërisë shqiptare. Diferenca midis më të moshuarit (të madhit Ismet Elezi) dhe më të riut (quhet Edison Zylalaj) është plot 64 vjet.

Pra, i dashur lexues, më 21 nëntor, në Tiranë, u hodhën themelet e një "godine" të bukur e shoqërisht të domosdoshme. Le të urojmë, bashkërisht, që të bëhet njëqindkatëshe!